

VENDIM
Nr. 257, datë 2.12.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“3AD ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2415/1 prot., datë 21.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “3AD Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “3AD Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2415 prot., datë 18.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gjerat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “3AD Energy” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 2314 rep., nr. 876 kol., datë 8.7.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier”;

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 9512/3 prot., datë 13.10.2023, për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më 7.12.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaik ‘3 AD Solar’, 2 mw”. Kjo VNM është aktualisht e vlefshme (deri më 7.12.2025), dhe në kuadër të fillimit të zbatimit në terren të projektit, shoqëria ka informuar se ka aplikuar për t’u pajisur me lejet përkatëse.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke iu referuar periudhës deri në 1 muaj para aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “3AD Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “3AD Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti